



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Artan Sulaj** me datë **16.10.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: Zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” vendosur ndaj shtetasit **Artan Sulaj** me vendimin nr.39, datë 14.04.2024 me një masë më të butë si ajo e “arrestit në shtëpi”.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, bazuar në nenet 112, 228 e vijues, 246/6, 260 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **583**, datë **05.11.2024**, vendosi:

1. Shqyrtimin në seancë gjyqësore të informacionit me shkrim në lidhje me gjendjen e procedimit penal nr. 188/2023 të Prokurorisë së Posaçme, dhe nevojat e sigurimit për të hetuarin **Artan Sulaj**.
2. Rrëzimin e kërkesës me nr. 583, datë 16.10.2024, për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” të caktuar me vendimin nr.37, datë 10.04.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si një kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 5(pesë) ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit, për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 05.11.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar